



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacija/Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, bazuar në vendimin e Ministres së MASHTI Nr. 01-1488 datë 11.04.2025 shpall:

## **KONKURS**

Për ndarjen e njëqind (100) bursave për nxënësit e regjistruar në klasën e 10-të në Institucionet e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (shkolla profesionale) për vitin shkollor 2025-2026, sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 136/2020. Gjashtëdhjetë (60) bursa për drejtimet deficitare dhe katërdhjetë (40) për drejtimet teknike për vajza.

Ndarja e bursave për nxënësit e IAAP-ve nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) bëhet me qëllim të mbështetjes së nxënësve në profile të rëndësishme për tregun e punës.

Vlera e bursës është 50 euro në muaj, përkatësisht 500 euro për një vit shkollor. Nxënësit përfitojnë bursë për tri vite të shkollimit nëse vijnë me sukses mësimet në IAAP.

### **Të drejtë aplikimi për bursë në drejtimet deficitare kanë:**

Të gjithë nxënësit të cilët regjistrohen në Institucionet e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (IAAP), të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara me konkurs, kanë të drejtë të aplikojnë për bursë në një nga drejtimet deficitare, në këto profile:

- Zhvillues i aplikacioneve softuerike
- Teknik i sistemeve solare fotovoltaike
- Pylltari
- Agrobiznes
- Automekanik
- Asistent i turizmit dhe udhëtimeve
- Përpunim druri/Zdrukhëtar

## **Të drejtë aplikimi për bursë në drejtimet teknike për vajza kanë:**

Të gjitha vajzat të cilat regjistrohen në Institucionet e Arsimit dhe Aftësisit Profesional (IAAP), të cilat i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në konkurs, kanë të drejtë të aplikojnë për bursë në një nga drejtimet teknike, në këto profile:

- Instalues elektrik
- Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit
- Automekanik
- Teknologjia e riciklimit
- Teknik i dizajnit grafik

## **Kushtet dhe kriteret e aplikimit për bursë:**

- 1.1.** Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës
- 1.2.** Suksesi i shkollimit paraprak – klasat 6-9 (60%)
- 1.3.** Rezultatet e testit të arritshmerisë (40%)

## **Dokumentacioni që kërkohet për aplikim:**

- Kërkesa për bursë, duke cekur edhe drejtimin për të cilin aplikon
- Dëftesën e shkollës së mesme të ulët (kopje)
- Certifikatën e lindjes

## **Procedurat e aplikimit**

- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentacionit bëhet në IAAP (shkollë)
- Drejtorët e IAAP-ve i dorëzojnë aplikacionet përmes arkivit në MASHTI/DAAP deri me **13.10.2025**
- Dokumentet e pakompletuara nuk shqyrtohen.

Konkursi do të jetë i hapur prej **12.09.2025 deri 13.10.2025**.

**E drejta e ankesës:** Nxënësit që kanë aplikuar por nuk kanë përfituar, kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh pas shpalljes së rezultateve nga MASHTI. Ankesat shqyrtohen nga organi epror në MASHTI.